

SHELL UPSTREAM ALBANIA B.V. – Dega ne Shqiperi

**Pasqyrat Financiare
per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017**

PERMBAJTJA:

PASQYRAT FINANCIARE

Faqe

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

3

PASQYRA E PERFORMANCES FINANCIARE

4

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN NETO

5

PASQYRA E FLUKSEVE TE MJETEVE MONETARE

6

SHENIME SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE

7-19

SHELL UPSTREAM ALBANIA B.V. – Dega ne Shqiperi
Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017
(te gjitha shumat jane te shprehura ne mije Leke, pervec se kur percaktohet ndryshe)

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

AKTIVET	Shenime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
AKTIVET AFATSHKURTRA			
Mjete monetare dhe ekuivalente te tyre	4	41,913	26,279
Llogari financimesh te brendshme	5	3,574,076	1,095,219
Te drejta te arketueshme	6	15,500	14,736
Aktive te tjera afatshkurtra	7	83,021	40,255
Inventari	8	1,321,631	881,231
		<u>5,036,141</u>	<u>2,057,720</u>
AKTIVET AFATGJATA			
Aktive kerkimi dhe vleresimi	9	33,878,804	27,570,219
		<u>33,878,804</u>	<u>27,570,219</u>
TOTALI I AKTIVEVE		<u>38,914,945</u>	<u>29,627,939</u>
DETYRIMET DHE KAPITALI			
DETYRIMET AFATSHKURTRA			
Llogari te pagueshme	10	1,416,126	1,668,659
Detyrime tatimore	11	18,843	16,154
Detyrime te perlllogaritura ndaj paleve te lidhura	12	5,458,945	3,452,690
		<u>6,893,914</u>	<u>5,137,503</u>
DETYRIMET AFATGJATA			
Fonde nga Shoqeria Meme	13	48,773,598	46,014,923
		<u>48,773,598</u>	<u>46,014,923</u>
TOTALI I DETYRIMEVE		<u>55,667,512</u>	<u>51,152,426</u>
KAPITALI			
Humbje te mbartura		(21,524,487)	(16,558,911)
Fitimi/(Humbja) e vitit		4,771,921	(4,965,576)
		<u>(16,752,567)</u>	<u>(21,524,487)</u>
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		<u>38,914,945</u>	<u>29,627,939</u>

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 7 deri 19 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

Keto Pasqyra Financiare jane miratuar nga Jan-Henk van Konijnenburg, Manaxher i Pergjithshem i Shell Upstream Shqiperi B.V. - Dega ne Shqiperi, me 29-03-2018.

Shell Upstream Albania B.V.
Dega e Shqiperise se Hual
Nipt : L218070091
TIRANA - ALBANIA

SHELL UPSTREAM ALBANIA B.V. – Dega ne Shqiperi
Pasqyra e Performances Financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017
(te gjitha shumat jane te shprehura ne mije Leke)

PASQYRA E PERFORMANCES FINANCIARE

	Shenime	2017	2016
Te ardhurat	14	9,648	9,597
Shpenzime te aktivitetit operativ			
Shpenzime personeli	15	(875,721)	(562,436)
Kapitalizimi i shpenzimeve te personelit	16	881,282	75,202
Shpenzime operative	17	(1,578,096)	(3,415,092)
Shpenzime te tjera	18	(2,233)	(6,040)
Totali i shpenzimeve te aktivitetit operativ		(1,574,768)	(3,908,366)
Humbja operative		(1,565,120)	(3,898,769)
Shpenzime financiare		(1,453,695)	(7,324,235)
Te ardhura financiare		7,790,736	6,257,428
Fitimi/(humbja) financiare neto	19	6,337,041	(1,066,807)
Fitimi/(Humbja) para tatimit		4,771,921	(4,965,576)
Shpenzimi per tatimin mbi fitimin	20	-	-
Fitimi/(Humbja) e vitit		4,771,921	(4,965,576)
Te ardhura te tjera gjitheperfshirese neto pas tatimit mbi fitimin		-	-
Fitimi/(humbja) gjitheperfshirese e vitit per Degen		4,771,921	(4,965,576)

Pasqyra e Performances Financiare duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 7 deri 19 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

SHELL UPSTREAM ALBANIA B.V. – Dega ne Shqiperi
Pasqyra e Ndryshimeve ne Kapitalin Neto per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017
(te gjitha shumat jane te shprehura ne mije Leke)

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN NETO

	<u>Humbje te mbartura</u>	<u>Kapitali total</u>
Gjendja me 1 janar 2016	(16,558,911)	(16,558,911)
Humbja e vitit	(4,965,576)	(4,965,576)
Te ardhura te tjera gjithetheperfshtese	-	-
Gjendja me 31 dhjetor 2016	(21,524,487)	(21,524,487)
Gjendja me 1 janar 2017	(21,524,487)	(21,524,487)
Fitimi i vitit	4,771,921	4,771,921
Te ardhura te tjera gjithetheperfshtese	-	-
Gjendja me 31 dhjetor 2017	(16,752,567)	(16,752,567)

Pasqyra e Ndryshimeve ne Kapitalin Neto duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 7 deri 19 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

SHELL UPSTREAM ALBANIA B.V. – Dega ne Shqiperi
Pasqyra e Flukseve te Mjeteve Monetare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017
(te gjitha shumat jane te shprehura ne mije Leke)

PASQYRA E FLUKSEVE TE MJETEVE MONETARE

	<u>2017</u>	<u>2016</u>
Aktivitetet operative		
Fitimi/(Humbja) e vitit	4,771,921	(4,965,576)
<i>Rregullime per:</i>		
Fitimet/(humbjet) e parealizuar nga kursi i kembimit per Fondet nga Shoqeria Meme	(6,637,117)	841,960
Te ardhura nga interesi	(22,922)	(9,196)
Humbja operative para ndryshimeve ne kapitalin punues	(1,888,119)	(4,132,812)
Ndryshimi ne inventar	(440,400)	(70,098)
Ndryshimi ne te drejtat e arketueshme	(764)	428,304
Ndryshimi ne aktivet e tjera afatshkurtra	(42,766)	196,831
Ndryshimi ne llogarite e pagueshme	(252,533)	1,526,212
Ndryshimi ne detyrimet tatimore	2,689	(3,204)
Ndryshimi ne detyrimet e perlllogaritura ndaj paleve te lidhura	2,006,256	2,880,742
Mjete monetare neto (perdorur ne)/nga aktivitetet operative	(615,638)	825,975
Aktivitetet te investimit		
Kostot e kerkimit dhe vleresimit	(6,308,585)	(8,686,200)
Interesa te marra	22,922	9,196
Mjete monetare neto perdorur ne veprimtari investuese	(6,285,663)	(8,677,004)
Aktivitetet te financimit		
Ndryshimi ne llogarite e financimeve te brendshme	(2,478,857)	(342,575)
Fonde te marra nga Shoqeria Meme	9,395,792	8,190,702
Mjete monetare neto nga veprimtaria financuese	6,916,935	7,848,128
Rritja/(pakesimi) neto ne mjete monetare dhe ekuivalente te tyre	15,634	(2,900)
Mjete monetare dhe ekuivalente te tyre ne 1 janar	26,279	29,179
Mjete monetare dhe ekuivalente te tyre ne 31 dhjetor	41,913	26,279

Pasqyra e Fluksit te Mjeteve Monetare duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 7 deri ne 19 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

SHELL UPSTREAM ALBANIA B.V. – Dega ne Shqiperi
Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017
(te gjitha shumet jane te shprehura ne mije Leke, pervec se kur percaktohet ndryshe)

1. INFORMACIONE TE PERGJITHSHME

Shell Upstream Albania B.V. – Dega ne Shqiperi (referuar ketej e tutje si “SUA” ose “Dega”) eshte dege e Shell Upstream Albania B.V., themeluar ne Hollande (referuar si “Shell” ose “Shoqeria Meme”), filial i shoqerise shumekombeshe te naftes dhe gazit Royal Dutch Shell plc. Dega eshte regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit, me 7 qershor 2012, ne perputhje me Ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, me numer unik identifikimi tatimor (NIPT) L21807009I. Numri i punonjesve te Deges me 31 dhjetor 2017 eshte 43 (31 dhjetor 2016: 38).

Aktiviteti kryesor i Deges eshte shpimi ne kerkim per hidrokarbure ne Shqiperi. Me 9 shkurt 2012, Shell Upstream Albania B.V. hyri ne Shqiperi permes nje marreveshje transferimi te 50% te interesit pjesemarres dhe marreveshje operimi te perbashket te Kontrates me Ndarje Prodhimi per Blloqet 2-3 (“KNP”), nje kontrate me qeverine shqiptare qe ne ate kohe operohej nga Petromanas Albania GmbH (“PMI”). Me 20 qershor 2013, Shell dhe Petromanas Albania GmbH nenshkruan nje shtese te marreveshjes se transferimit per KNP-ne per Blloqet 2-3 ne Shqiperi, marreveshje e lidhur fillimisht mes paleve ne shkurt 2012. Kjo shtese i siguroi Shell nje interes pjesemarres shtese prej 25%. Shell mori ne zoterim plotesisht 100% te interesit me 1 mars 2016 pas blerjes se 25% te interesit te mbetur nga Petromanas Albania GmbH dhe, si rrjedhoje e ketij procesi, Shell mori rolin e Operatorit per Blloqet 2-3.

Operacionet e shpimit ne pusin Shpirag-3 filluan me 5 qershor 2016 ne perputhje me kerkesat e KNP-se. Operacionet ne pusin Shpirag-3 u pezulluan ne dhjetor 2017. Ne janar 2018, Dega ka filluar operacionet e shpimit ne pusin Shpirag-4.

Ne shkurt 2018, Dega ka nenshkruar nje tjetër KNP me qeverine shqiptare, per Bllokun 4, ne jug te Blloqeve 2-3, e cila eshte ende subjekt ratifikimi nga Keshilli i Ministrave.

2. BAZAT E PERGATITJES

2.1 Deklarata e perputhshmerise

Keto pasqyra financiare jane pergatitur ne perputhje me Standardet Kombetare te Kontabilitetit ne Shqiperi te publikuara nga Keshilli Kombetar i Kontabilitetit ne Shqiperi dhe te permiresuara me efekt nga 1 janar 2015.

Disa prej shumave krahasuese te vitit te kaluar jane riklasifikuar per t’iu pershtatur paraqitjes ne vitin aktual.

2.2 Parimi i vijimesise

Deri me 31 dhjetor 2017, Dega ka akumuluar humbje prej 16,752,567 Leke (2016: 21,524,487 Leke) te cilat i atribuohet fazes se eksplorimit per Blloqet 2-3. Gjate kesaj faze, Dega eshte mbeshketur me financime afatgjata nga Shoqeria Meme per kryerjen e operacioneve te eksplorimit dhe vleresimit dhe per permbushjen e nevojave per likuiditet. Shoqeria Meme eshte e angazhuar te vazhdoje ofrimin e nje mbeshketjeje te tille financiare edhe ne te ardhmen, ne varesi te nevojave operacionale.

Bazuar ne sa eshte shprehur me lart, drejtuesit besojne se Dega do te jete ne gjendje te vazhdoje aktivitetin sipas parimit te vijimesise dhe nuk ka asnje qellim per likuidimin e operacioneve

2. BAZAT E PERGATITJES (VAZHDIM)

2.2 Parimi i vijimesise (vazhdim)

ne nje te ardhme te afert. Per rrjedhoje, Dega i ka pergatitur keto pasqyra financiare ne baze te parimit te vijimesise.

2.3 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne koston historike.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Keto pasqyra financiare jane prezantuar ne Leke, e cila eshte njekohesisht dhe monedha funksionale e Deges. Te gjitha vlerat jane rrumbullakosur ne te mijten me te afert, pervec se kur eshte percaktuar ndryshe.

2.5 Perdorimi i vleresimeve dhe gjykimeve

Pergatitja e pasqyrave financiare kerkon nga drejtuesit e Deges te ushtrojne gjykimin e tyre ne procesin e zbatimit te politikave kontabel te Deges dhe ne raportimin e te gjithe vlerave te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund te ndryshoje nga keto vleresime. Vleresimet dhe gjykimet rishikohen ne menyre te vazhdueshme. Rishikimet e vleresimeve kontabel njihen ne periudhen ne te cilen vleresimi eshte rishikuar, si dhe ne periudhat e ardhme qe preken.

Informacioni mbi fushat me te rendesishme te vleresimeve, pasigurise dhe gjykimeve kritike ne zbatimin e politikave kontabel ne keto pasqyra financiare eshte perfshire ne shenimet vijuese.

3. POLITIKAT KONTABEL TE RENDESISHME

Politikat kontabel te meposhtme jane zbatuar ne menyre konsistente ne te gjitha periudhat e paraqitura ne keto pasqyra financiare.

3.1 Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale dhe regjistrohen me kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare ne monedhe te huaj ne daten e raportimit konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten e raportimit. Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates se kryerjes se transaksionit, ndersa ato qe maten me vlere te drejte rikembehene ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates kur eshte percaktuar vlere e drejte. Diferencat qe rezultojne nga kursi i kembimit njihen pergjithesisht ne fitime ose humbje.

Kursi i kembimit i monedhave te huaja me 31 dhjetor 2017 dhe 2016 eshte detajuar si me poshte:

Kurset e kembimit	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Leke/EUR	132.95	135.23
Leke/ USD	111.10	128.17

3. POLITIKAT KONTABEL TE RENDESISHME (VAZHDIM)

3.2 Instrumenta financiare

Instrumentat financiare jo-derivative perbehen nga te drejta te arketueshme, mjete monetare dhe ekuivalente te tyre, llogari te financimeve te brendshme, llogari te pagueshme, detyrime te perlllogaritura ndaj paleve te lidhura dhe detyrime ndaj Shoqerise Meme.

Te gjitha aktivet dhe detyrimet financiare njihen fillimisht me vleren e drejte plus çdo kosto transaksioni qe lidhet me to. Pas njohjes fillestare, instrumentat financiare jo-derivative njihen siç pershkruhet me poshte.

Nje instrument financiar njihet nese Dega behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojne te drejtat kontraktuale te Deges mbi flukset e parase se aktivitet financiar ose kur Dega transferon aktivin financiar tek nje pale e trete pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe perfitimet thelbësore te aktivitet. Blerjet dhe shitjet normale te aktiveve financiare kontabilizohen ne daten e transaksionit, qe eshte data ne te cilen Dega angazhohet te bleje apo te shese aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nese detyrimet kontraktuale te Deges skadojne, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to perfshijne arken, llogarite rrjedhese dhe depozitat bankare. Per qellimin e pasqyres se flukseve te mjeteve monetare, mjetet monetare perfshijne depozita me afat maturimi prej tre muajsh ose me pak qe nga data e fillimit. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre mbahen me koston e amortizuar ne pasqyren e pozicionit financiar.

Llogarite e financimit te brendshem

Llogarite e financimit te brendshem paraqesin gjendjen e mjeteve monetare te grumbulluara nga shoqerite e grupit dhe te vena ne dispozicion per Degen. Ato mbarten me kosto te amortizuar ne pasqyren e pozicionit financiar.

Te drejta te arketueshme

Te drejtat e arketueshme njihen fillimisht me vleren e drejte dhe me pas me kosto te amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvleresimi. Provigjioni per zhvleresimin e te drejtave te arketueshme llogaritet kur ka te dhena se Dega nuk do te jete ne gjendje te mbledhe te gjitha detyrimet. Veshtiresite financiare te debitorit, mundesia qe debitori te falimentoje ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues qe te drejtat e arketueshme te zhvleresohen. Shuma e provigjionit eshte llogaritur si difference midis vleres se mbetur dhe vleres aktuale te flukseve monetare te ardhshme te skontuara me normen e interesit efektiv.

Llogarite e pagueshme, detyrimet e perlllogaritura ndaj paleve te lidhura, fondet nga Shoqeria Meme

Llogari te pagueshme, detyrime te perlllogaritura ndaj paleve te lidhura, fondet nga Shoqeria Meme paraqiten me vleren e tyre te drejte dhe me pas me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv.

3. POLITIKAT KONTABEL TE RENDESISHME (VAZHDIM)

3.2 Instrumenta financiare (vazhdim)

Vlera e drejte

Vlera e drejte e vleresuar per mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, te drejtat e arketueshme, llogarite e pagueshme, detyrimet te perlllogaritura ndaj paleve te lidhura, fondet nga Shoqeria Meme, i perafrohen vleres se tyre kontabel.

Zhvleresimi

Nje aktiv financiar rivleresohet ne çdo date raportimi per te percaktuar nese ekzistojne evidenca objektive qe vertetojne zhvleresimin e tij. Aktivet financiare zhvleresohen kur ekzistojne prova qe vlera e ardhshme e flukseve te parase qe gjeneron aktivin jane ndikuar. Per aktivet financiare te mbajtur me kosto te amortizuar, shuma e zhvleresimit eshte diferenca midis vleres se mbetur te aktivitetit dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parase te skontuar me normen efektive fillestare te interesit te aktivitetit financiar.

Aktivitetet financiare te cilat individualisht kane nje peshe te ndjeshme testohen per zhvleresim ne baza individuale. Pjesa e mbetur e aktiveve financiare vleresohen te grupuar ne kategori qe kane karakteristika te perbashketa risku. Te gjitha humbjet nga zhvleresimi njihen ne rezultatin e periudhes.

3.3 Inventari

Inventari perfshin materiale dhe pjese kembimi te blera dhe mbajtura me qellim per t'u perdorur ne operacionet e eksplorimit dhe vleresimit. Ai njihet fillimisht me kosto dhe me vone vleresohet ne pasqyren e pozicionit financiar me vleren me te ulet mes koston dhe vleres se realizueshme neto. Kur materialet dhe pjeset e kembimit vihen ne perdorim, elementet perkates riklasifikohen si aktive kerkimi dhe vleresimi.

3.4 Kerkimi dhe vleresimi

Kostot e kerkimit dhe vleresimit, duke perfshire koston e blerjes se licences dhe shpenzimet e pergjithshme administrative drejtperdrejt te lidhura me te, njihen si aktive materiale ose jo materiale te kerkimit dhe vleresimit ne varesi te natyres se aktivitetit te blere. Interesat dhe shpenzimet e tjera te financimit nuk kapitalizohen ne aktivet e kerkimit dhe vleresimit.

Njohja, matja dhe çregjistrimi i aktiveve te kerkimit dhe vleresimit kryhen duke iu referuar Standardit Nderkombetar te Raportimit Financiar 6 "Kerkimi dhe Vleresimi i Burimeve Minerare". Standardet Kombetare te Kontabilitetit shqiptare lejojne referimin ne Standardet Nderkombetare te Kontabilitetit dhe Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar per trajtimin kontabel te elementeve te cilet nuk trajtohen ne menyre te posaçme dhe te mjaftueshme ne Standardet Kombetare te Kontabilitetit shqiptare.

Shpenzimet qe lidhen me aktivitetet e kerkimit dhe vleresimit jane grumbulluar ne qendra kostosh ne baze puseshe, fushash dhe zonash eksplorimi ne pritje te percaktimit te pershtatshmerise teknike dhe tregtare.

3. POLITIKAT KONTABEL TE RENDESISHME (VAZHDIM)

3.4 Kerkimi dhe vleresimi (vazhdim)

Pershtatshmeria teknike dhe tregtare e nje licence konsiderohet te jete e percaktueshme ne baze te disa treguesve, duke perfshire percaktimin e rezervave te provuara. Rishikimi i cdo licence ose fushe kerkimi kryhet te pakten nje here ne vit, ne menyre qe te sigurohet nese projekti eshte i pershtatshem nga pikepamja teknike dhe tregtare. Pas percaktimit te pershtatshmerise teknike dhe tregtare te mjaftueshme, aktivet e kerkimit dhe vleresimit qe lidhen me keto rezerva, testohen per zhvleresim dhe pastaj riklasifikohen nga aktivet e kerkimit dhe vleresimit ne nje kategori te vecante brenda aktiveve afatgjata materiale qe njihet si interesat e naftes.

Zhvleresimi

Aktivt e kerkimit dhe vleresimit testohen per zhvleresim ne nivelin e njesise se gjenerimit te parave ("NjGjP") kur riklasifikohen si aktive prodhuese (interesat e naftes dhe gazit natyror dhe/ose pajisje), ose nese faktet dhe rrethanat sugjerojne qe vlera e mbetur tejkalon vleren e rikuperueshme. Nje NjGjP perbehet nga grupi me i vogel i mundshem i aktiveve qe gjenerojne flukse parash qe jane te pavarura nga aktivet e tjera apo grupet e tjera te aktiveve. Dega aktualisht nuk ka ende asnje NjGjP per faktin se ndodhet ende ne fazen e eksplorimit dhe nuk gjeneron asnje fluks parash ne hyrje nga aktivet e saj te naftes dhe gazit natyror.

3.5 Provizionet

Nje provizion njihet nese, si rezultat i ngjarjeve te meparshme, Dega ka nje detyrim ligjor ose konstruktiv, i cili mund te vleresohet me besueshmeri dhe do te kerkoje flukse dalese monetare te ardhshme per shlyerjen e tij. Provizionet percaktohen duke skontuar flukset monetare te ardhshme te pritshme me nje norme skontimi para tatimit, e cila reflekton vleresimin aktual te tregut per vleren ne kohe te parase dhe rreziqet qe lidhen me detyrimin ne fjale.

3.6 Njohja e te ardhurave

Te ardhurat njihen kur eshte e mundshme qe perfitimet ekonomike te lidhura me to do te vijne ne favor te Deges dhe kur vlera e tyre mund te matet ne menyre te besueshme. Te ardhurat nga shitja e mallrave njihen kur rreziqet dhe perfitimet thelbesore te lidhura me pronesine transferohen nga shitesi te bleresi. Te ardhurat nga kryerja e sherbimeve njihen duke iu referuar fazes se perfundimit te transaksionit ne daten e raportimit.

3.7 Te ardhura dhe shpenzime financiare

Te ardhurat financiare perfshijne te ardhura interesi nga llogarite bankare dhe fitime nga kursi i kembimit qe njihen ne fitime ose humbje.

Shpenzimet financiare perfshijne shpenzimet per interesa nga huate dhe humbjet nga kursi i kembimit. Te ardhurat nga interesi dhe shpenzimet e interesit njihen mbi bazen e te drejtave te konstatuara duke perdorur metoden e interesit efektiv.

3. POLITIKAT KONTABEL TE RENDESISHME (VAZHDIM)

3.8 Tatimi mbi fitimin

Ne baze te Ligjit nr. 7811, date 12.04.1994, i ndryshuar "Per miratimin me ndryshime te Dekretit nr. 782, date 22.02.1994 "Per sistemin fiskal ne sektorin e hidrokarbureve"" tatimi mbi fitimin llogaritet ne baze te KNP-se se nenshkruar midis PMI dhe Ministrise se Energjise dhe Industrise, ne te cilen SUA eshte bere pale permes marrjes se 50%, te 25% e me pas te 25% te interesit pjesmarres. Ne baze te ketij ligji specifik, fitimet e tatueshme perfaqesohen nga Fitimi Hidrokarbur sic perkufizohet ne KNP, i cili llogaritet ne baze te totalit te te ardhurave pas mbulimit/rikuperimit te te gjitha shpenzimeve operative dhe kapitale, teresisht ne momentin qe kryhen (pa amortizim), gjate periudhes se eksplorimit dhe vleresimit, zhvillimit dhe prodhimit ("kostot e rikuperueshme hidrokarbure"). Fitimet e tatueshme te llogaritura si me lart jane subjekt i tatimit mbi fitimin ne baze te normes specifike per kete industri ne nivelin e 50%. Raportet e kostove te rikuperueshme hidrokarbure dorezohen prane Agjensise Kombetare te Burimeve Natyrore ("AKBN") ne baza tremujore per miratim. Kostot e rikuperueshme hidrokarbure mbarten per nje kohe te papercaktuar deri ne rikuperimin e tyre te plote kundrejt prodhimit hidrokarbur.

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin perfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyre. Tatimi mbi fitimin aktual dhe tatimi mbi fitimin i shtyre njihen ne fitim ose humbje me perjashtim te pjeses qe lidhet me zera te njohur direkt ne kapital, rast ne te cilin njihet ne kapital ose ne te ardhura te tjera gjithepershireshe.

Tatimi aktual eshte tatimi qe pritet te paguhet mbi fitimin e tatueshem te vitit, duke perdorur normen tatimore te caktuar ne KNP dhe ligjet specifike te industrise qe jane miratuar apo qe jane ne thelb te miratuara ne daten e raportimit, sic pershkruhet me lart, si dhe pas çdo sistemimi/rregullimi te tatimit te pagueshem te lidhur me vitet e meparshme.

Tatimi i shtyre njihet ne lidhje me diferencat e perkohshme ndermjet vleres kontabel neto te aktiveve dhe detyrimeve per qellime te raportimit financiar dhe shumave te perdorura per qellime tatimi.

Aktivi tatimor i shtyre njihet per kostot rikuperueshme te hidrokarbure ende te parikuperuara, humbjet tatimore te paperdorura, kreditimet tatimore te paperdorura dhe diferencat e perkoheshme te zbritshme ne masen qe eshte e mundur qe fitimi i tatueshem i ardhshem do te jete i disponueshem kundrejt te cilit ato mund te perdoren. Aktivet tatimore te shtyra rishikohen ne çdo date raportimi dhe zvogelohen deri ne masen qe nuk eshte me e mundur qe te realizohen perfitimet perkatese tatimore.

Aktivitet tatimore te shtyra te panjohura rivleresohen ne çdo date raportimi dhe njihen ne ate mase qe eshte bere e pritshme te kete fitime te tatueshme te ardhshme perkundrejt te cilave ato te mund te perdoren.

Tatimi i shtyre matet me normat e tatimit qe pritet te aplikohen ndaj diferencave te perkohshme kur ato te permbysen, duke perdorur normen tatimore ne fuqi ose qe konsiderohet si e tille ne daten e raportimit.

Aktivitet dhe detyrimet tatimore te shtyra kompensohen nese plotesohen disa kritere.

SHELL UPSTREAM ALBANIA B.V. – Dega ne Shqiperi
Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017
(te gjitha shumat jane te shprehura ne mije Leke, pervec se kur percaktohet ndryshe)

4. MJETE MONETARE DHE EKVIVALENTE TE TYRE

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Mjete monetare ne arke ne Leke	240	273
Mjete monetare ne banke		
Ne Leke	35,648	22,437
Ne Euro	6,025	3,569
Totali	41,913	26,279

5. LLOGARI FINANCIMESH TE BRENDSHME

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Llogari e perbashket financimi brenda grupit	3,574,076	1,095,219
Totali	3,574,076	1,095,219

Llogarite e financimit te brendshem konsistojne ne nje llogari te perbashket mjetes monetare brenda grupit ne dispozicion te Deges.

6. TE DREJTA TE ARKETUESHME

Te drejtat e arketueshme me 31 dhjetor 2017 dhe 2016 jane te perbera si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Llogari te arketueshme tregtare	15,500	14,736
Totali	15,500	14,736

7. AKTIVE TE TJERA AFATSHKURTRA

Aktivete tjera afatshkurtra me 31 dhjetor 2017 dhe 2016 perbehen nga sa me poshte:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Llogari te arketueshme tatimore	61,804	23,428
Parapagime te tjera	21,217	16,827
Totali	83,021	40,255

Llogarite e arketueshme tatimore me 31 dhjetor 2017 perbehen vetem nga TVSH-ja e rimbursueshme, ndersa me 31 dhjetor 2016 perfshin TVSH-ne e rimbursueshme dhe nje mbipagese te tatimit ne burim.

SHELL UPSTREAM ALBANIA B.V. – Dega ne Shqiperi**Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017***(te gjitha shumat jane te shprehura ne mije Leke, pervec se kur percaktohet ndryshe)***8. INVENTARI**

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Materiale dhe pjese kembimi	1,321,631	881,231
Totali	1,321,631	881,231

Inventari perbehet nga materiale dhe pjese kembimi qe priten te perdoren ne aktivitetet e kerkimit dhe te vleresimit.

9. AKTIVE KERKIMI DHE VLERESIMI

Aktivitet e kerkimit dhe vleresimit me 31 dhjetor 2017 dhe 2016 analizohen si me poshte:

Kosto	<u>Totali</u>
Gjendja me 1 janar 2016	18,884,019
Shtesa	8,686,200
Gjendja me 31 dhjetor 2016	27,570,219
Shtesa	6,308,585
Gjendja me 31 dhjetor 2017	33,878,804

Aktivitet e kerkimit dhe vleresimit perbehen nga kosto te projekteve te eksplorimit te kapitalizuara nga Dega ne pritje te percaktimit te rezervave te provuara apo ato te mundshme. Shtesat gjate 2016 perfaqesojne pjesen e shpenzimeve te Deges perpara dates 1 mars 2016 dhe shpenzimet e vete Deges pas dates 1 mars 2016 (pas marrjes se rolit te operatorit te KNP-se per Blloqet 2-3) te kryera per aktivitetet e kerkimit dhe vleresimit.

10. LLOGARI TE PAGUESHME

Llogarite e pagueshme me 31 dhjetor 2017 dhe 2016 perbehen nga sa me poshte:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Llogari te tjera te pagueshme te perlllogaritura	1,359,762	1,145,439
Te pagueshme ndaj furnitoreve	56,364	523,220
Totali	1,416,126	1,668,659

Llogari te tjera te pagueshme te perlllogaritura perbehen nga sherbime te cilat jane furnizuar gjate vitit por faturat perkatese nuk jane leshuar ende dhe nuk jane regjistruar ende si te pagueshme ndaj furnitoreve ne fund te vitit.

SHELL UPSTREAM ALBANIA B.V. – Dega ne Shqiperi
Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017
(te gjitha shumat jane te shprehura ne mije Leke, pervec se kur percaktohet ndryshe)

11. DETYRIMET TATIMORE

Detyrimet tatimore me 31 dhjetor 2017 dhe 2016 perbehen nga sa me poshte:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Tatimi mbi te ardhurat personale nga punesimi dhe sigurimet shoqerore e shendetesore	18,843	16,154
Totali	<u>18,843</u>	<u>16,154</u>

12. DETYRIME TE PERLLOGARITURA NDAJ PALEVE TE LIDHURA

Detyrimet e perlllogaritura ndaj paleve te lidhura me 31 dhjetor 2017 dhe 2016 perbehen nga sa me poshte:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Shell International Exploration and Production BV	2,296,650	1,558,295
Shell International Limited	1,935,174	1,247,330
Shell UK E&P-UK EU	359,431	179,928
Shell Global Solutions	265,371	172,247
Shell Finance BV	115,454	74,306
Te tjere	486,865	220,584
Totali	<u>5,458,945</u>	<u>3,452,690</u>

13. FONDET NGA SHOQERIA MEME

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Financime afatgjata	48,773,598	46,014,923
Totali	<u>48,773,598</u>	<u>46,014,923</u>

Fondet nga Shoqeria Meme ne shumen prej 48,773,598 Leke, ekuivalent i 439,070 mije Dollare (31 dhjetor 2016: 46,014,923 Leke, ekuivalent i 359,070 mije Dollare) perbehen nga nje financim afatgjate pa interes dhe rrjedhin pjesisht nga nje kredi pa interes nga nje pale e lidhur me Shoqerine Meme dhe pjesisht nga primi i aksioneve te kontribuar nga aksionari i Shoqerise Meme tek Shoqeria Meme. Rritja per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 prej 2,758,675 Leke (31 dhjetor 2016: 9,032,663 Leke) rrjedh nga nje financim shtese prej 9,395,792 Leke, ekuivalent i 80,000 mije Dollare te marra gjate vitit (31 dhjetor 2016: 8,190,702 Leke, ekuivalent i 65,000 mije Dollare) dhe nga fitimet e parealizuar nga kursi i kembimit ne vleren e 6,637,117 Leke (2016: humbjet e parealizuar nga kursi i kembimit 841,960 Leke) (shih shenimin 19).

SHELL UPSTREAM ALBANIA B.V. – Dega ne Shqiperi**Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017***(te gjitha shumat jane te shprehura ne mije Leke, pervec se kur percaktohet ndryshe)***14. TE ARDHURAT**

	<u>2017</u>	<u>2016</u>
Te ardhura te tjera	9,648	9,597
Total	9,648	9,597

Te ardhurat per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 jane ne shumen e 9,648 Leke dhe perbehen nga nje shitje rastesore e disa materialeve te perdorura gjate aktiviteve te kerkimit. Te ardhurat per vitin e mbyllur ne 31 dhjetor 2016 jane ne shumen e 9,597 Leke dhe perbehen nga nje shitje rastesore e inventarit te acidit te perdorur ne testet gjate aktiviteve te kerkimit.

15. SHPENZIMET E PERSONELIT

Shpenzimet e personelit per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 dhe 2016 perbehen nga sa me poshte:

	<u>2017</u>	<u>2016</u>
Paga	851,603	550,802
Kontribute te sigurimeve shoqerore e shendetesore	21,223	10,737
Kosto te tjera te personelit	2,895	897
Totali	875,721	562,436

16. KAPITALIZIMI I SHPENZIMEVE TE PERSONELIT

Shpenzimet e personelit te kapitalizuara ne aktivet e kerkimit dhe vleresimit per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 dhe 2016 perbehen nga sa me poshte:

	<u>2017</u>	<u>2016</u>
Kosto te personelit te lidhura direkt me aktivet e kerkimit dhe vleresimit	(881,282)	(75,202)
Totali	(881,282)	(75,202)

Kostot e personelit te lidhura direkt me aktivet e kerkimit dhe vleresimit perfaqesojne shpenzime per paga, kontribute te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore dhe kosto te tjera te personelit te cilat jane riklasifikuar/shtuar aktiveve te kerkimit dhe vleresimit (shih shenimin 9). Kostot e kapitalizuara per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 ne vleren 881,282 Leke perbehen nga kostot e personelit te vitit aktual prej 621,900 Leke dhe kostot e personelit per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016 prej 259,383 Leke. Kostot qe i perkasin vitit 2016 jane riklasifikuar ne vitin 2017 (kur jane identifikuar) dhe jo ne menyre restrospektive, pasi gabimi eshte konsideruar si jomaterial nga drejtimi i Shoqerise mbeshtetur ne Standardin Kombetar te Kontabilitetit nr. 1.

SHELL UPSTREAM ALBANIA B.V. – Dega ne Shqiperi**Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017***(te gjitha shumat jane te shprehura ne mije Leke, pervec se kur percaktohet ndryshe)***17. SHPENZIME OPERATIVE**

Shpenzimet operative per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 dhe 2016 perbehen nga sa me poshte:

	<u>2017</u>	<u>2016</u>
Kosto te pergjithshme administrative	1,610,105	2,715,089
Nxjerrja jashte perdorimi e inventarit	(40,900)	596,424
Kosto sizmike	8,652	85,147
Kosto te zhvillimit te biznesit	239	18,432
Totali	<u>1,578,096</u>	<u>3,415,092</u>

Kosto te pergjithshme administrative perfshijne kosto te kryera ne mbeshtetje te aktiviteteve te kerkimit, sherbime manaxhimi xhenerike, sherbime per platformen tokesore dhe kosto te tjera te kryera ne mbeshtetje te aktiviteteve te kerkimit te tilla si sherbime finance, ligjore dhe konsulenca te tjera, menaxhim zyre, IT dhe telekomunikacion, siguracion, etj.

Çregjistrimi i inventarit per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016 me vlere 596,424 Leke eshte rezultat i nje auditimi te brendshem mbi inventarin. Pas nje numerimi fizik te inventarit te kryer nga Dega gjate vitit 2017, eshte rimarre pjeserisht nje pjese e inventarit me nje vlere prej 40,900 Leke qe u identifikua si ekzistues dhe ne kushte te pershtatshme per perdorim ne aktivitetet e kerkimit.

18. SHPENZIME TE TJERA

	<u>2017</u>	<u>2016</u>
Gjoba	1,767	5,383
Sponsorizime / Donacione	466	657
Total	<u>2,233</u>	<u>6,040</u>

Shpenzime te tjera per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 perfshijne gjoba tatimore dhe interesa per pagese te vonuar te detyrimeve tatimore ne shumen 1,767 Leke (2016: 5,383 Leke).

SHELL UPSTREAM ALBANIA B.V. – Dega ne Shqiperi
Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017
(te gjitha shumat jane te shprehura ne mije Leke, pervec se kur percaktohet ndryshe)

19. FITIMI/(HUMBJA) FINANCIARE NETO

Fitimi/(humbja) financiare neto per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 dhe 2016 analizohet si me poshte:

	<u>2017</u>	<u>2016</u>
Shpenzime financiare		
Humbje e parealizuar nga kursi i kembimit per Fondet nga Shoqeria Meme	-	(841,960)
Humbje e tjera nga kursi i kembimit	(1,453,562)	(6,482,023)
Komisione bankare	(133)	(252)
	<u>(1,453,695)</u>	<u>(7,324,235)</u>
Te ardhura financiare		
Fitimi i parealizuar nga kursi i kembimit per Fondet nga Shoqeria Meme	6,637,117	-
Fitime te tjera nga kursi i kembimit	1,130,697	6,248,232
Te ardhura nga interesat	22,922	9,196
	<u>7,790,736</u>	<u>6,257,428</u>
Fitimi/(humbja) financiare neto	<u>6,337,041</u>	<u>(1,066,807)</u>

Fitimi financiar neto per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 i atribuohet kryesisht fitimeve te parealizuara nga kursi i kembimit qe lindin nga efekti i renies se kursit te kembimit Leke-Dollare gjate vitit 2017 mbi Fondet nga Shoqeria Meme, te cilat arketohen dhe jane te ripagueshme ne Dollare (shih shenimin 13).

20. SHPENZIMI PER TATIMIN MBI FITIMIN

Shpenzimi per tatimin mbi fitimin aktual dhe shpenzimi per tatimin mbi fitimin e shtyre per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 dhe 2016 jane zero.

Norma tatimore efektive eshte zero ne krahasim me normen tatimore nominale prej 50% meqenese nuk ka fitim te tatueshem pergjate ketyre viteve.

Me 31 dhjetor 2017 dhe 2016, nuk eshte njohur asnje aktiv tatimor i shtyre, si rezultat i pasigurive te fitime te tatueshme te ardhshme perkundrejt te cilave mund te perdoren.

SHELL UPSTREAM ALBANIA B.V. – Dega ne Shqiperi
Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017
(te gjitha shumat jane te shprehura ne mije Leke, pervec se kur percaktohet ndryshe)

21. TRANSAKSIONE ME PALET E LIDHURA

Nje permbledhje e transaksioneve dhe balancave me palet e lidhura eshte prezantuar si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Te arketueshme:		
Llogari financimesh te brendshme (shenimi 5)	3,574,076	1,095,219
Te pagueshme:		
Detyrime te perlllogaritura ndaj paleve te lidhura (shenimi 12)	5,458,945	3,452,690
Fonde nga Shoqeria Meme (shenimi 13)	48,773,598	46,014,923
Kosto te perlllogaritura:		
Shell International Exploration & Production	2,296,650	1,558,295
Shell International Limited	1,935,174	1,247,330
Shell UK E&P-UK EU	359,431	179,928
Shell Global Solutions	265,371	172,247
Shell Finance BV	115,454	74,306
Te tjera pale te lidhura	486,865	220,583

22. NGJARJET PAS DATES SE RAPORTIMIT

Nuk kane ndodhur ngjarje te rendesishme pas dates se raportimit te cilat kane nevoje per rregullim apo paraqitje ne keto pasqyra financiare.

INVENTARI I MALLRAVE
31.12.2017

Subjekti
NIPT
Aktiviteti
Adresa Vep.
Telefoni

SHOQERIA: Shell Upstream Albania B.V. - Dega ne Shqiperi
NIPT: L218070091

Blv. Bajram Curri, Godina ETC, Kati 4, Tirane

Nr.	Artikulli	Nj/M	Sasia	Kosto/njesi	Vlera
1	Material dhe pjese kembimi te perdorura ne aktivitetin e keridmit				1,321,631
	Shuma				1,321,631

Administrator i Shoqerise
Jan-Henk van Konijnenburg



Aktivet Afatgjata Materiale me vlere fillestare 2017

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 01.01.2017	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31.12.2017
1	Toka	0	0	0	0	0
2	Ndertime	0	0	0	0	0
3	Makineri,paisje,vegla	0	0	0	0	0
4	Mjete transporti	0	0	0	0	0
5	Pajisje Kompjuterike dhe Informative	0	0	0	0	0
6	Pajisje Zyre	0	0	0	0	0
8	Te tjera	0	0	0	0	0
	TOTALI	0	0	0	0	0

Amortizimi A.A.Materiale 2017

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 01.01.2017	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31.12.2017
1	Toka	0	0	0	0	0
2	Ndertime	0	0	0	0	0
3	Makineri,paisje,vegla	0	0	0	0	0
4	Mjete transporti	0	0	0	0	0
5	Pajisje Kompjuterike dhe Informative	0	0	0	0	0
6	Pajisje Zyre	0	0	0	0	0
7	Te tjera	0	0	0	0	0
	TOTALI	0	0	0	0	0

Vlera Kontabel Neto e A.A.Materiale 2017

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 01.01.2017	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31.12.2017
1	Toka	0	0	0	0	0
2	Ndertime	0	0	0	0	0
3	Makineri,paisje,vegla	0	0	0	0	0
4	Mjete transporti	0	0	0	0	0
5	Pajisje Kompjuterike dhe Informative	0	0	0	0	0
6	Pajisje Zyre	0	0	0	0	0
7	Te tjera	0	0	0	0	0
	TOTALI	0	0	0	0	0

Administrator i Shoqerise
Jan-Henk van Konijnenburg

23-3-2018
Shell Upstream Albania B.V.
Dega e Shoqerise se Hual
Nipt : L218070091
TIRANA - ALBANIA

INVENTARI I AUTOMJETEVE NE PRONESI TE SUBJEKTIT
31.12.2017

Subjekti

SHOQERIA: Shell Upstream Albania B.V. - Dega ne Shqiperi

NIPT

NIPT: L21807009I

Aktiviteti

Adresa Vep.

Blv. Bajram Curri, Godina ETC, Kati 4, Tirane

Telefoni

-

Nr.	Lloji Automjeteve	Kapacitet	Targa	Vlera
1	Toyota land Cruiser	2.9 CC	AA538DZ	0
2	Toyota land Cruiser	2.9 CC	AA759EJ	0
3	Toyota land Cruiser	2.9 CC	AA574HM	0
4	Toyota land Cruiser	2.7 CC	AA648AM	0
5	Toyota APV	1.9CC	AA874EM	0
	Shuma			0

Shenim:

29-3-2018
Administrator i Shoqerise
Jan-Henk van Konijnenburg

